

Sektori i veprave civile, të Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në bazë të nenit 91 paragrafi 3 të Ligjit të gjykatave (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.58/2006...96/2019), të nenit 68 të Rregullores gjyqësore (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.66/2013), të nenit 34 paragrafi 2 dhe nenit 41 të Rregullores së punës së Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.13/1998 dhe 21/2009), në seancën e mbajtur më 25.05.2021, miratoi:

M E N D I M J U R I D I K

Kur revizioni është deklaruar për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, ndërsa nuk është theksuar se cilën dispozitë të së drejtës materiale gjykata nuk e ka zbatuar, por do të duhej ta zbatojë ose e ka zbatuar në mënyrë të gabuar, Gjykata supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në përputhje me nenin 377 paragrafi 3 të Ligjit për procedurë kontestimore nuk i kushton rëndësi sipas detyrës zyrtare zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

A r s y e t i m

Gjykata supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke vendosur për lëndët konkrete në procedura të revizioneve të deklaruara, erdhi në përfundim se duhet të shqyrtohet për çështjen juridike, nëse gjykata revizore është e detyruar t’i vlerësojë, të dhënat e cituara në revizionin për zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, në të cilën nuk është theksuar përmbajtja e cenimit të së drejtës materiale, por as nuk është theksuar se cilën dispozitë nga e drejta materiale gjykata nuk e ka zbatuar, dhe që duhet ta zbatojë ose e ka zbatuar në mënyrë të gabuar.

Sektori i veprave civile, të Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke shqyrtuar për çështjen e parashtruar juridike, miratoi mendim juridik që rrjedh nga vet dispozitat e Ligjit për procedurë kontestimore, që kanë të bëjnë me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale si shkak për deklarimin e revizionit.

Me dispozitën e nenit 345 të Ligjit për procedurë kontestimore (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.79/05...124/15), përcaktohen rastet kur mund të konsiderohet se e drejta materiale është zbatuar gabimisht në procedurën kontestimore. Në këtë drejtim, zbatim të gabuar të së drejtës materiale ka atëherë kur gjykata nuk e ka zbatuar dispozitën e të drejtës materiale që duhet ta zbatojë ose kur dispozitën e tillë nuk e ka zbatuar në rregull.

Mundësia për të deklaruar revizion për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, është e paraparë me dispozitën e nenit 375 paragrafi 1 pika 3 nga i njëjti Ligj.

Në përputhje me nenin 377 paragrafi 1 nga i njëjti Ligj, pala në revizion duhet t'i theksojë saktë shkaqet për arsye të së cilave është deklaruar. Në përputhje me paragrafin 3 nga i njëjti nen, gjykata revizore e shqyrton aktgjykimin e hedhur poshtë vetëm në atë pjesë që ajo hidhet poshtë me revizionin dhe në kufijtë e shkaqeve që janë saktë të theksuara në revizion.

Duke u nisur nga përmbajtja e nenit 377 paragrafi 3 të Ligjit për procedurë kontestimore, në mënyrë të padiskutueshme rrjedh se Gjkata supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nuk mund t' i kushtojë rëndësi sipas detyrës zyrtare zbatimit të gabuar të së drejtës materiale gjatë vendosjes në procedurën e revizionit, pa u theksuar saktë përmbajtja e cenimit të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Kjo për shkak se, me dispozitën ligjore nga neni 377 paragrafi 3 të Ligjit për procedurë kontestimore veç më është lëshuar rregulli, që përfshihet në nenin 372 të Ligjit për procedurë kontestimore ("Gazeta zyrtare e RM" 33/98), sipas të cilës dispozitë, krahas tjerash, gjykata revizore sipas detyrës zyrtare i kushton rëndësi edhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

**Gjkata supreme e
Republikës së Maqedonisë së Veriut
Sektori i veprave civile**